



Prishtinë, 29 janar 2024
Kodi i ZRRE-së: V_1835_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
 - Nenin 18 par. 1 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së; dhe
 - Vendimin V_1749_2023 të datës 18 gusht 2023,
- në seancën e mbajtur më 29 janar 2024 nxori këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit V_1749_2023 të datës 18 gusht 2023

- I. Ndryshohet dhe plotësohet dispozitivi nën pikën II. të Vendimit V_1749_2023 i datës 18 gusht 2023 i nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, me tekstin si në vijim:

Pas fjalës "Bankë Komerciale" shtohet teksti "apo kompani e sigurimeve" ndërsa fjalia në vazhdim mbetet e pandryshuar.

- II. Obligimet tjera të vendosura me Vendimin _1749_2023 i datës 18 gusht 2023 i nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, mbesin në fuqi.

A r s y e t i m

- o ZRRE në mbledhjen e mbajtur me datë 18 gusht 2023, përmes Vendimit V_1749_2023 ka lëshuar Autorizim, për shoqërinë SOLAR ENERGY GROUP EUROPE SH.P.K. për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, me kapaciteti prej 150 MW, ZK Vranic dhe Bec, komuna e Gjakovës, sipas Lejes Ndërtimore të lëshuar nga MMPHI.
- o ZRRE përmes Vendimit sipas dispozitivit nën pikën II. ka kërkuar nga shoqëria "SOLAR ENERGY GROUP EUROPE" SH.P.K., që të dorëzoj garancionin bankar në vlerë prej 7% të vlerës së projektit, të lëshuar nga një Bankë Komerciale e licencuar në Republikën e Kosovës, me vlefshmëri që mbulon periudhën gjashtëmbëdhjetë (16) mujore sipas Planin Dinamik të Realizimit të dorëzuar nga Aplikuesi.



- ZRRE me datë 23.08.2023 përmes emaili zyrtar i ka dorëzuar aplikuesit Vendimin për Autorizim dhe Draft Garancioni Bankar që duhet të plotësohet dhe sigurohet nga ana e Aplikuesit.
- Aplikuesi me datë 23 shtator 2023 dhe me datë 04 tetor 2023 ka parashtruar kërkesë për afat shtesë për sigurimin e garancionit financiar, duke paraqitur edhe arsyetimet dhe vështirësitë e Bankave vendore për sigurimin e vlerës së garancionit.
- ZRRE me datë 08 dhjetor 2023 nga aplikuesi ka pranuar Garancionin financiar (Polica e Sigurimit e Garancisë së Ekzekutimit të Kontratës), Deklaratën e Garantuesit dhe dokumentin e ZRRE-së (Garancioni i Kërkuar i Pakushtëzuar që mbulon periudhën 08.12.2023-08.04.2025).
- ZRRE me 12 dhjetor 2023 iu ka drejtuar Bankës Qendrore të Kosovës, me të cilën ka kërkuar nëse ky Garancion Financiar është i vlefshëm, dhe i pranueshëm sipas legjislacionit të aplikuar, për faktin se ZRRE e ka për herë të parë një formë të tillë të Garancionit, e posaçërisht të lëshuar nga një Kompani e Sigurimeve për vlerën e tillë.
- ZRRE me datë 22.12.2023 nga Banka Qendrore e Kosovës ka pranuar përgjigje me shkrim, ku njoftohet se: Bazuar ne kërkesën tuaj, me qëllim të mbështetjes në aspektin ndër-institucional, si dhe rolin këshillëdhënës ndaj autoriteteve publike, në kuadër të komunikimit të vazhdueshëm mbikëqyrës me siguruësin dhe qasjes proaktive, BQK ka kërkuar informacione paraprake nga siguruësi, lidhur me këtë rast në aspektin e menaxhimit të rrezikut. Informacionet e siguruar në parim, tregojnë se siguruësi është i vetëdijshëm dhe përgatitur të marr përsipër përgjegjësinë financiare nga ky rast.
- Megjithatë, kanë sugjeruar që paraprakisht të pranoni vetëm një Garanci të pakushtëzuar, të siguroheni dhe paraprakisht të merrni konfirmim nga garantuesi, për autenticitetin dhe origjinalitetin e dokumentit e pranuar, dhe gjithashtu konstatoni nëse i njëjti përputhet me kërkesat tuaja të procesit të shpallur, që të ofroje sigurinë e nevojshme sipas qëllimit të këtij produkti financiar.
- ZRRE me datë 26.12.2023 iu ka drejtuar Kompanisë së Sigurimeve ELSIG me kërkesë për konfirmim paraprakisht për autenticitetin dhe origjinalitetin e dokumenteve të pranuar, se janë lëshuar dhe plotësuar nga Kompania e Sigurimeve ELSIG SH.A., si dhe përmbushjen e detyrimeve sipas legjislacionit në fuqi.
- ZRRE me datë 27.12.2023 nga kompania ELSIG ka pranuar konfirmimin si në vijim: *“Sipas kërkesës suaj, ne konfirmojmë se klienti SOLAR ENERGY GROUP EUROPE SH.P.K sipas kërkesave ligjore të Rregullës së Autorizimit dhe Vendimit V_1749_2023 të datës 18 shtator 2023, ka kërkuar tek ne Garancionin financiar (Polica e Sigurimit e Garancisë së Ekzekutimit të Kontratës) dhe ne, pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës kemi dhënë klientit: “Deklaratën e Garantuesit Policen e Sigurimit nr. 120613 dhe dokumentin e ZRRE-së, me kushtet e kërkuara (që mbulon periudhën 07.12.2023-08.04.2025)”. Prandaj ne konfirmojmë origjinalitetin dhe autenticitetin e dokumenteve gjegjësisht garancionit të ofruar për klientin. Gjithashtu konfirmojmë se janë zbatuar të gjitha procedurat dhe kushtet e parapara për këtë lloj produkti të marrjes së rrezikut të vendosura dhe mbikëqyrura nga BQK si dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës”.*




- ZRRE vlerëson se marr parasysh të gjitha ato që u përmendën më lartë, dhe në kuptim të zbatimit të ligjshmërisë së dispozitave ligjore të Rregullës nr. 03/2023 për Procedurën e Autorizimit për Projektet e Energjisë, për të zbatuar drejt Nenit 18 par. 1 ku definohet citojmë: *"Me Vendimin për lëshimin e Autorizimit, ZRRE kërkon nga Aplikuesi që të dorëzojë në ZRRE një garanci financiare, të lëshuar nga një bankë komerciale apo kompani e sigurimeve me vlefshmëri që mbulon periudhën nga lëshimi i Autorizimit deri në përfundimin e ndërtimit të Projektit Energjetik"* është propozuar që të bëhet plotësimi i dispozitivit nën pikën II. të Vendimit V_1749_2023 në rreshtin e tretë, ku pas tekstit "Bankës Komerciale" shtohet teksti si në vijim: *"apo kompani të sigurimeve"* ndërsa fjalia në vazhdim mbetet e pandryshuar.
- Gjithashtu me këtë ndryshim dhe plotësim Garancioni Financiar i lëshuar nga kompania e Sigurimeve ELSIG, për shoqërinë SOLAR ENERGY GROUP EUROPE SH.P.K, bëhet i pranueshëm dhe projekti mund të realizohet sipas vendimit për lëshimin e autorizimit dhe legjislacionit të aplikueshëm për këtë projekt.
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit dhe vlerësimit dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:



Ymer Fejzullahu, Kryesues



Lutfije Dervishi, Anëtare



Gani Bucaj, Anëtar



Arta Isufi, Anëtare



Adnan Prenqi, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Arkivit të ZRRE-së.